



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Kaçanik
Skupština Opština
Municipal Assambly
- Komiteti për Politikë dhe Financa-
01Nr. 16-3329/2012
Kaçanik, 20.02.2012

RAPORT PUNE
I
KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA,
për vitin , 2011

Kaçanik, shkurt, 2012

RAPORT PUNE I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA , për vitin ,2011

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF-a) i formuar nga kuvendi i komunës më datë: 20.01.2010, si trup i përhershëm punues i kuvendit, edhe në vitin 2011, e ka vazhduar aktivitetin e vet më të njëjtit anëtarë dhe ate: Xhelal Gashi, Zekirja Loku, Arbnora Sallahu, Kemajl Murseli, Shukri Luta, Shyqeri Luzha dhe Daut Rudi, më kryesuesin, Xhelal Gashi, sipas funksionit që ka.

Sipas Ligjit Nr.03/L-040 -Për Vetëqeverijen Lokale, Statutit të Komunës dhe kompetencave të bartura nga kuvendi i komunës, për gjat përdhës raportuese KPF-a është munduar që në suaza të kompetencave të veta të i realizoj detyrat të cilat janë parashtruar.

Në këtë drejtim me angazhimin e vet, kjo trupë punuese është munduar që të formuloj aso zgjidhje dhe t'i hulumtoj drejtimet me adekuate për zhvillimin e komunës, e më këtë krijimin e kushteve për një jetë sa më t'mirë të qytetarëve të komunës. Veprimtarinë e vet e ka orientuar në fusha të ndryshme të cilat me legjislacionin në fuqi i janë lënë në kompetencë. Kjo veprimtari gjatë periudhës raportuese, marrë parasysh gjendjen jo aq të mirë të cilën gjindet komuna, ishte mjaft e gjërë, paraqitën nevoja të ndryshme dhe ky komitet ka arritur në një masë të i realizoj detyrat të cilat janë parshtruar, por asesi nuk është i knaqur pasiqë nevojat e shumëta të qytetarëve të komunës na bëjnë që edhe më tutje të angazhohemi në zgjidhjen e çështjeve jetike.

Aktiviteti i Komitetit për Politikë dhe Financa është zhvilluar në takime të rregullta mujore. Gjat periudhës raportuese ky komitet ka mbajtur gjithsej 11 mbledhje të rregullta. Mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa kanë qenë të suksesshme dhe konstruktive. Angazhimi i anëtarëve të KPF-a ka qenë në nivel të duhur. Prezenca e anëtarëve të këtij komiteti mund të vlerësohet se ka qenë shumë e rregullt. Në mbledhjet e KPF-a ka mbretëruar një frymë e punës dhe e bashkëpunimit në mes të subjekteve politike të përfaqësuara në këtë komitet. Për të gjitha mbledhjet e KPF-a është mbajtur procesverbal i cili ruhet me pedantëri dhe është transparent në çdo kohë.

Në këto takime janë shqyrtuar çështje të ndryshme për komunën. Për çështjet e shqyrtuara në këtë komitet janë marrë edhe vendime adekuate. Për të gjitha çështjet të cilat është dashur të debatoj kuvendi në seancën e vet, ky komitet paraprakisht i ka shqyrtuar dhe e ka dhënë mendimin e vet. Në këtë drejtim ky komitet ka shqyrtuar 28 çështje për të cilat i Rekomandon kuvendit marrjen e vendimit adekuat.

Duke marrë parasysh natyrën e çështjeve të cilat janë parashtruar ka marrë gjithsej; 17 Vendime brenda kompetencave të veta dhe atyre të bartura nga kuvendi, për të cilat ka konsideruar se janë në të mirë të zhvillimit të komunës. Po ashtu në çdo mbledhje të KPF-a është aprovuar procesverbali i mbledhjes së kaluar të KPF-a.

Vlenë për t'u theksuar se për çdo çështje që ka shqyrtuar ky komitet, është hartuar akti konform vendimit të KPF-a.

Në takimet e kësaj trupe punuese kanë marrë pjesë kryesisht, kryetari apo nënkryetari i komunës dhe drejtorët e drejtorive komunale dhe të njëjtët i kanë arsyetuar çështjet e propozuara sipas fushës së tyre. Gjithashtu ekzekutivi i komunës në mbledhjet e KPF-a ka dhënë edhe Informacione tjera të nevojshme aty për aty apo në formë të shkruar për çështje të ndryshme dhe sipas kërkesave të KPF-a.

Bashkëpunimi i KPF-a me stafin ndërkombëtarë gjat periudhës raportuese ka qenë në nivelin e duhur. Ftesa për mbledhje i është dërguar stafit të OSBE-së, të cilët kryesisht i kanë monitoruar mbledhjet. Disa nga mbledhjet i kanë monitoruar edhe përfaqësues nga strukturat e KFOR-it.

Punën e këtij organi e kanë përcjellë edhe; zyrtari për Informim, gazetarët dhe Radio Kaçaniku.

Çështjet e shqyrtuara:

Komiteti për Politikë dhe Financa gjat periudhës raportuese i ka shqyrtuar gjithsej : 45 propozim vendime. Propozim Vendimet e shqyrtuara janë materiale të pregaditura nga shërbimet përkatëse profesionale të komunës . Propozim Vendimet kanë qenë të natyrave të ndryshme. Në kuadër të propozim Vendimeve janë shqyrtuar çështje të cilat kanë të bëjnë me rregullativën normative, çështje buxhetore, raporte dhe programe të punës së ekzekutivit të komunës, raporte financiare, ndërrime të destinimit të tokës bujqësore dhe çështje tjera më rëndësi për komunën.

Në vazhdim do të i potencojmë çështjet të cilat kanë qenë në shqyrtim të Komitetit për Politikë dhe Financa;

Rregullativa normative:

Në kuadër të kësaj sfere bëjnë pjesë aktet normative të cilat kanë qenë në shqyrtim të këtij komiteti e që u janë përcjellë kuvendit për shqyrtim dhe miratim. Në këtë drejtim ky Komitet ka shqyrtuar 4 akte normative të propozuara nga shërbimet përkatëse profesionale, dhe ato:

- Projekt- Rregullorën për transparencë komunale,
- Projekt- Rregullorën për vendosjen e tatimit në pronë në teritorin e komunës së Kaçanikut, për vitin 2012,
- Projekt-Rregullorën për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të komunës së Kaçanikut dhe
- Projekt-Rregullorën për të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e nxënësve të shkollave të mesme të larta të komunës së Kaçanikut.

Këtyre akteve normative KPF-a iu ka kushtuar rëndësi e veçantë, janë dhënë vërejtjet nga kjo trupë punuese dhe të njëjtat me Rekomandim të këtij komiteti i janë përcjellë Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim dhe në procedurë të mëtutjeshme. Kontribut të veçantë në çështjen e rregullativës normative, KPF-a ka dhënë edhe në Debate publike të organizuara më qytetarë.

Draftet-Buxhetore dhe Raportet Financiare:

Si çdo herë kur janë shqyrtuar çështjet buxhetore edhe në vitin 2011, KPF-a ka i ka kushtuar rëndësi të veçant, Kornizën afatmesme të shpenzimeve të komunës së Kaçanikut për vitet: 2012-2014 dhe Buxhetit të komunës së Kaçanikut, për vitin fiskal 2012 dhe vlerësimet për vitet 2013-2014.

Korniza afatmesme e shpenzimeve është dokument fillestar për hartimin e buxhetit të komunës. Dokumentet përcjellëse që i kanë paraprirë hartimit të buxhetit për vitin 2012 janë: Qarkorja e brendshme buxhetore komunale Nr. 2012/01 dhe Qarkorja e brendshme buxhetore komunale Nr.02/2012- kufijtë buxhetor specifik të drejtorive komunale. Vetëm për Draftin kornizë dhe dokumentet tjera përcjellëse, KPF-a ka debatuar gjerë e gjatë e ka dhënë mendimin e vet dhe ia ka Rekomanduar kuvendit të komunës për shqyrtim dhe në procedurë të debatit publik më qytetarë. Në dëgjime publike me qytetarë, përpos organeve të administratës komunale kanë qenë të obliguar të marrin pjesë edhe anëtarët e KPF-a, të cilët në këtë drejtim e kanë dhënë kontributin e tyre.

Projektbugjeti i Komunës për vitin fiskal 2012 dhe kërkesat e projektuara për v.2013 dhe 2014. Në këtë dokument, KPF-a i ka dhënë propozimet e veta për projektet që duhet të hyjnë në realizim më buxhetin afatmesëm të komunës për vitet: 2012-2014. Në këtë drejtim Komiteti për Politikë dhe Financa e ka aprovuar Buxhetin e komunës për vitin 2012 në shumë: 5,457.754 €, dhe projeksionet për vitet 2013-2014, në shumat buxhetore : 5,528.999 € për vitin 2013 dhe: 5.574.176 € për vitin 2014. Edhe në këtë plan afatmesëm buxhetorë, KPF-a i ka futur synimet për secilën veprimtari konform Statutit të Komunës, çdo herë duke iu dhënë prioritet Listës së Projekteve Kapitale, në këtë drejtim ka propozuar që të zgjerohet lista e projekteve kapitale edhe më 6 projekte tjera nga 53 në 59, ndërsa ka shprehur paknaqësitë e tij në një ndarje shumë të ulët të buxhetit të komunës krahasuar me numrin e popullsisë së kësaj komune më regjistrimet e reja (vitit 2011) dhe nevojave të shumëta të kësaj popullate. Duke marrë për bazë faktin se më buxhetin e ndarë për projekte kapitale, nuk mund të realizohen të gjitha projektet e aprovuara, mirëpo gjithëherë është menduar në angazhimin e organeve të komunës, në nivelin qendror dhe më gjerë për gjetjen e ndonjë donacioni më qëllim që projektet e aprovuara të realizohen. Kontributin e vet për çështjen e buxhetit të komunës, KPF-a e ka dhënë edhe në debatet e organizuara më qytetarë.

Të gjitha këto çështje pas vlerësimit të thukët nga KPF-a, u janë përcjellë Kuvendit të Komunës për shqyrtim e miratim.

Nga Raportet Financiare, KPF-a, ka aprovuar;

- Raportin Vjetor Financiar për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010,
- Raportin Financiar të komunës së Kaçanikut, për periudhën: janar-mars, 2011,
- Raportin e realizimit të mjeteve buxhetore për periudhën: janar-qershor,2011,

-Raportin e realizimit të mjeteve buxhetore për periudhën, janar-shtator 2011,

-Kornizën afatmesme të shpenzimeve të komunës së Kaçanikut për vitet: 2012-2014.

Të çështja e raporteve financiare vlenë të permendet se, KPF-a, në disa sektorë vlerëson se janë përmbushur objektivat konform planifikimit të të hyrat vetjake komunale, ndërsa në disa sektorë në raport më planifikimin ka qenë më pak i knaqur dhe këto paknaqësi kjo trupë punuese i ka shprehur tek ekzekutivi i komunës dhe sugjerimet e KPF-a kanë ndikuar në një angazhim më të madh të sektorëve të caktuar që inkasimi i të hyrave vetjake komunale në sektorë të caktuar të shënoj ngritje. Ndërkaq si çdo vit tjetër edhe në vitin 2011, Komiteti për Politikë dhe Financa e vlerëson pozitiv realizimin e të hyrave nga Tatimi në Pronë.

Në Raportet financiare, vlenë të cekët se KPF-a ka kërkuar sqarime shtesë të shpenzimeve buxhetore në programe të caktuara buxhetore sa herë që janë shqyrtuar raportet financiare aty ku ka patur pakjartësi ndërsa për çdo shpenzim që KPF-a ka menduar se është i madh apo më pak i arsyeshëm në raport më nevojat të tjera ka dhënë vërejtjet dhe sugjerimet e tija.

Propozim Vendimet:

Me qëllim që mos të ngelin mjete buxhetore në suficit apo bartje të mjeteve buxhetore në vitin vijues buxhetor, KPF-a ka shqyrtuar dhe aprovuar:

Rritjen e buxhetit të komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2011 nga të hyrat vetjake komunale dhe shpërndarja e tyre për shpenzime, Rialokimin e mjeteve nga ndarjet bugjetore 2011 në kategorinë e projekteve kapitale, Bartjen e bilanceve të pashpënzura nga të hyrat vetjake komunale të vitit 2009 dhe 2010, në vitin vijues bugjetor 2011, dhe transferin e shumave të ndara bugjetore për vitin 2011.

Për çdo ndryshim buxhetor të propozuar, KPF-a ka kërkuar sqarime të nevojshme nga propozuesi pse ka ardhur deri të ndryshimet buxhetore, e në veçanti ka kërkuar arsye të projektet kapitale që kanë qenë në listë për realizim e nuk janë realizuar në kohën e përcaktuar.

Ndërkaq me qëllim që rregullimit të zonës urbane të qytetit të Kaçanikut sipas planeve të aprovuara, KPF-a, iu ka kushtuar rëndësi të veçant ;

Planit Rregullues Urban, për Zonën e I-rë Urbanistike të qytetit të Kaçanikut, Trajtimin e Zonës së I-rë Urbanistike dhe Zonës përkufizuese që ka ndikimin në Zonën e I-rë dhe Vërtetimin e interesit të përgjithshëm publik për zgjerimin-ndërtimin e parkut të qytetit.

KPF-a gjat periudhes raportuese ka shqyrtuar dhe aprovuar edhe këto propozim vendimet si në vijim; Ndalimin e organizimit të disa lojërave të fatit në teritorin e komunës së Kaçanikut, Formimin e komisionit për emërimin dhe riemërimin e rrugëve lokale si dhe Formimin e Komitetit të Auditimit. Për të gjitha këto çështje, janë dhënë vërejtjet dhe sugjerimet nga KPF-a dhe të njëjtat i janë Rekomanduar kuvendit të komunës për shqyrtim dhe miratimin e tyre.

Vendimet;

Komiteti për Politikë dhe Financa, në kuadër të fushëveprimtarisë së vet ka marrë 17 vendime. Në këtë drejtim vend të posaqëm zënë ; 02 dokumentet përcjellëse që shërbejnë si bazë për hartimin e buxhetit të komunës për vitin 2011, si: Qarkorja e brendshme buxhetore komunale Nr. 2012/01 dhe Qarkorja e brendshme buxhetore komunale Nr. 02/2012-. kufijtë buxhetor specifik të drejtorive komunale dhe pregaditja e dorëzimeve buxhetore të drejtorive-programeve buxhetore për vitet 2012-2014, ndërkaq ka aprovuar gjithsej: 15 vendime vendime për ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore.

-Çështje të tjera:

Ndër çështjet tjera që ka vënë në shqyrtim kjo trupë punuese është:

- Raporti i Punës së Komitetit për Politikë dhe Financa, për vitin 2010,
- Raporti i ekzekutivit të komunës për periudhën: janar-dhjetor, 2010,
- Plani i Punës së ekzekutivit të komunës për vitin 2011,
- Plani i Punës së ekzekutivit të komunës për vitin 2012,
- Informatë për përfundimin e vitit shkollor 2010/2011
- Planin e veprimit rinor lokal për vitet: 2011-2013, dhe dhe çështje të tjera më rëndësi për komunën

KPF-a i ka shqyrtuar në detaje të gjitha raportet dhe planet e punës së ekzekutivit të komunës, ka dhënë vërejtjet dhe sugjerimet e veta dhe të njëjtat ia ka rekomanduar kuvendit të komunës në procedurë për shqyrtim dhe aprovim.

Punët dhe detyrat e punës së KPF-a pregaditen nga një zyrtar i punësuar në Shërbimin për punë profesionale të kuvendit të Komunës. Me angazhimin e këtij zyrtari pregaditen mbledhjet e KPF-a, pregaditet materiali i nevojshëm, përpilohet procesverbali i mbledhjes, vendimet dhe shkresat tjera të dalura nga mbledhjet e kësaj trupe punuese dhe të njëjtat arkivohet për nevojat e Shërbimit Civil të Komunës . Të njëjtat punë Ky zyrtar i kryen edhe për Kuvendin e Komunës.

P e r f u n d i m

Komiteti për Politikë dhe Financa është i vetëdijshëm se gjat periudhes raportuese nuk ka qenë në gjendje të i realizoj të gjitha synimet e veta në drejtim të zgjedhjes së çështjeve si pasojë e së kaluarës dhe me një buxhet të limituar, por angazhimi i tyre jep shpresë se në një të ardhme të afërt dhe me një angazhim permanent në gjetjen e donacioneve etj. gjendja do të përmirësohet.

Komiteti për Politikë dhe Financa është i mendimit se veprimtarinë e vet në të ardhmën do t'a orientoj në arritjen synimeve në realizimin e projekteve kapitale më rëndësi ekonomike, duke u bazuar në Planin Zhvillimor Urban dhe në Planin Zhvillimor Komunal dhe realizimin e projekteve më prioritet sipas Listës së aprovuar.

Shkurt, 2012,

Për Komitetin për Politikë dhe Financa,
Kryesuesi i kuvendit, z. Xhelal Gashi